



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3495 Prot

Tiranë, më 10.06, 2020

URDHËR

Nr. 170, datë 10.06.2020

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SKEMËN E KOMPENSIMIT DHE
FUNKSIONIMIN E BORDIT DISIPLINOR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 42, pika 13, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullore për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Bordi Disiplinor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)



RREGULLORE PËR SKEMËN E KOMPENSIMIT DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT DISIPLINOR

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme për skemën e kompensimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, bazuar në kërkesat e ligjit për noterinë dhe parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 2 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

- a) “Bordi Disiplinor” do të thotë organ hetimor “*ad hoc*”, i cili mbështetet administrativisht nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe shqyrton kërkesat e Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj noterëve ose zëvendësnoterëve;
- b) “Hetime” janë tërësia e veprimeve procedurale administrative që ndërmerren nga Bordi Disiplinor për të sqaruar një çështje të veçantë;
- c) “Provë” është çdo e dhënë, dëshmi, dokument apo fakt që shërben në nxjerrjen e konkluzioneve të procedimit disiplinor dhe që merret sipas dispozitave ligjore dhe të kësaj rregulloreje;
- ç) “Dëshmitar” është personi i thirrur nga Bordi Disiplinor për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet, vetëm dhe për shkak të lidhjes me çështjen objekt shqyrtimi;
- d) “Ekspertë” janë persona që për shkak të njohurive të posaçme në fushat e shkencës, teknikës apo në fusha të tjera specifike thirren nga Bordi Disiplinor, kur kjo e fundit e konsideron të përshtatshme;
- dh) “Vendim jo përfundimtar” është vendimi i Bordit Disiplinor, i marrë në çdo fazë të procedimit disiplinor për zhvillimin normal të veprimtarisë dhe procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, shtyrjes së seancës, angazhimit të ekspertëve dhe përcaktimit të detyrave të tyre, pranueshmërinë e provave, si dhe për çdo çështje tjetër që Bordi Disiplinor e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes;
- e) “Vendim përfundimtar” është vendimi që merret nga Bordi Disiplinor, për pranimin e kërkesës për procedim disiplinor dhe marrjen e një ose më shumë masave disiplinore ose rrëzimit të kërkesës.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë së Bordit

Bordi Disiplinor është krijuar me ligj për të hetuar, shqyrtuar dhe vendosur mbi të gjitha rastet që lidhen me procedimet disiplinore ndaj noterëve ose zëvendësnoterëve, pas paraqitjes së raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore përkatëse nga Ministri i Drejtësisë.

TITULLI II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I BORDIT DISIPLINOR

Neni 4

Mënyra e organizimit të Bordit Disiplinor dhe kompensimi

1. Mbledhja e Bordit Disiplinor është e vlefshme kur në të janë të pranishëm jo më pak se 3 anëtarë.
2. Kryetari i Bordit Disiplinor zgjidhet me shumicë absolute në mbledhjen e parë të Bordit, në prani të të gjithë anëtarëve të Bordit Disiplinor.
3. Bordi Disiplinor mblidhet jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i mandatit të kryetarit për të zgjedhur kryetarin e ri.
4. Veprimtaria administrative e Bordit Disiplinor mbështetet nga stafi administrativ i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
5. Masa e kompensimit është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për Kryetarin e Bordit Disiplinor dhe 10 000 (dhjetë mijë) lekë për secilin anëtar të Bordit Disiplinor për çdo procedim disiplinor.
6. Dhoma kryen kompensimin e Kryetarit, si dhe anëtarëve të Bordit Disiplinor nga buxheti i saj jo më vonë se data 5 e çdo muaji pasardhës, në rastet kur gjatë muajit ka pasur procedime disiplinore.
7. Shpenzimet për mbulimin e kostove administrative të punës së Bordit Disiplinor përballohen nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

Neni 5

Kompetencat funksionale të Bordit Disiplinor

1. Bordi Disiplinor shqyrton të gjitha raportet e hetimit së bashku me dosjet hetimore për procedimin disiplinor ndaj noterëve ose zëvendësnoterëve të paraqitura nga Ministri i Drejtësisë.
2. Bordi Disiplinor kryen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ në përputhje me normat e Kodit të Procedurave Administrative, kur ligji për noterinë nuk parashikon ndryshe.

Neni 6

Detyrat e Kryetarit dhe anëtarit të Bordit Disiplinor

1. Kryetari i Bordit Disiplinor kryen këto detyra:
 - a) administron raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore të paraqitur nga Ministri i Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj noterit ose zëvendësnoterit;
 - b) informon palët për zhvillimin e seancës së paku 10 ditë përpara;
 - c) cakton dhe njofton kohën dhe vendin e seancës dhe merr konfirmimin me shkresë ose mjete elektronike të anëtarëve të Bordit Disiplinor, palëve si dhe personave të tjerë të interesuar të cilët do të jenë pjesëmarrës në seancë. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt. Në rast se subjekti i procedimit disiplinor ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk është i pranishëm, vlerëson shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe që nuk vlerësohen të arsyeshme, vendos vijimin e seancës pa praninë e subjektit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Në rastet kur vlerësohet se subjekti i procedimit ka paraqitur shkaqe të arsyeshme apo shkaqe të cilat vlerësohen si të tilla, Bordi shtyn mbledhjen duke kryer një njoftim të dytë për një datë tjetër sa më të afërt. Nëse edhe në këtë datë subjekti i njoftuar rregullisht dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten para Bordit, vendoset vazhdimi i seancës në mungesë.
 - ç) cakton dhe njofton rendin e ditës së mbledhjes si dhe cakton relatorin e çështjes, referuar dosjes hetimore përkatëse për procedim disiplinor të paraqitur nga Ministri i Drejtësisë;
 - d) informon anëtarët e Bordit në lidhje me detyrimin për t'u shprehur brenda 2 (dy) ditësh nga momenti i marrjes së njoftimit, nëse kanë konflikt interesi apo dyshime mbi paanësinë e tyre në vendimmarrjen e Bordit Disiplinor, si dhe noterin/zëvendësnoterin, subjekt të procedimit disiplinor nëse ka konflikt interesi me një prej anëtarëve të Bordit Disiplinor;
 - dh) merr vendim për tërheqjen e anëtarit të Bordit Disiplinor, kur ka konflikt interesi apo ka dyshime në lidhje me paanësinë e tyre në vendimmarrje, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës së seancës;
 - e) hap, mbyll dhe drejton seancën duke siguruar mbarëvajtjen në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
 - ë) pyet nëse ka kërkesa paraprake nga palët. Kërkesat paraprake vlerësohen nga Bordi Disiplinor me vendim jo përfundimtar.
 - f) shtyn apo mbyll para kohe mbledhjet, në mënyrë të përligjur, duke e arsyetuar me vendim të pasqyruar në procesverbalin përkatës;
 - g) nënshkruan të gjithë aktet e nxjerra nga Bordi Disiplinor;
 - gj) administron materialet e nevojshme, të cilat mund të kërkohen nga anëtarët e tjerë;
 - h) kryen ballafaqimet dhe saktësimet e kërkuara nga anëtarët e tjerë si dhe njofton mbylljen e diskutimeve;
 - i) thërret dëshmitarë nëse ka, për dëshmi shtesë apo ekspertët nëse janë të angazhuar nga Bordi;
 - j) u jep fjalën anëtarëve të tjerë të Bordit ose personave të tjerë të interesuar, nëse ata e kërkojnë, për të paraqitur pretendimet dhe sqarimet e tyre;

- k) siguron zbatimin e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm për organet kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike dhe marrjen e vendimeve të drejta.
2. Në rastet kur Kryetari, nuk therret mbledhjen brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 7 ose nuk merr pjesë në të, pavarësisht shkakut, detyrat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ushtrohen nga anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë që ka më shumë vite përvojë profesionale si jurist.
3. Anëtari i Bordit Disiplinor kryen të paktën këto detyra:
- a) përcjell me shkrim ose në rrugë elektronike konfirmimin për pjesëmarrje në mbledhjen e Bordit pranë Kryetarit të Bordit Disiplinor;
 - b) bën relatimin e çështjes në seancë para Bordit Disiplinor, në rastin kur ai është anëtari i zgjedhur nga Kryetari sipas germës “ç” të pikës 1 të këtij neni;
 - c) ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij duke respektuar parimin e konfidentalitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;
 - ç) tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, nëse ndodhet para kushteve të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1 të këtij neni.
 - d) voton për vendimet që merr Bordi Disiplinor, me përjashtim të rastit kur tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, sipas germës “ç”, të pikës 2 të këtij neni.

Neni 7

Mbledhja e Bordit Disiplinor

1. Bordi Disiplinor mblidhet dhe zhvillon seancën dëgjimore jo me vonë se 15 ditë nga paraqitja e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore nga Ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor.
2. Kryetari cakton datën e mbledhjes jo më vonë se 3 ditë nga marrja e raportit të hetimit. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë çdo anëtari të Bordit. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore mund të zgjatet deri në 45 ditë, nëse Bordi Disiplinor është i bindur se ka arsye të rëndësishme për shtyrjen.
3. Dokumentimi i veprimtarisë së Bordit Disiplinor pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga sekretari që zgjidhet nga rradhët e anëtarëve, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Kryetarit dhe përmban:
 - a) datën dhe vendin e mbledhjes;
 - b) anëtarët që marrin pjesë në mbledhje;
 - c) çështjet që u diskutuan në mbledhje;
 - ç) vendimet që u morën në mbledhje, argumentet për vendimmarrje, afatet e përcaktuara në vendimmarrje;
 - d) dorëheqjet e anëtarëve dhe arsyetimet përkatëse;
 - dh) formën e votimit (i hapur ose jo) dhe rezultatin e tij;
 - e) rezultatet e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar;
4. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga Kryetari, sekretari dhe një nga anëtarët e zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë.

5. Mbledhjet e Bordit Disiplinor dokumentohen edhe nëpërmjet regjistrimit audio.
6. Një kopje e procesverbalit të mbledhjes, regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është e mundur dhe të çdo materiali tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj depozitohet së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar pranë Ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

Detyrimi për të marrë pjesë në mbledhje

1. Pjesëmarrja në mbledhjet e Bordit Disiplinor është e detyrueshme. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, konsiderohet që ka hequr dorë si anëtar i Bordit Disiplinor. Në këtë rast kryetari njofton menjëherë organin e emërtesës dhe Ministrin e Drejtësisë. Në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme, detyrimin për të njoftuar sipas këtij neni e ka anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë që ka më shumë vite përvojë profesionale si jurist.
2. Organi i emërtesës fillon procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të Bordit Disiplinor jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 9

Marrja e vendimeve nga Bordi Disiplinor

1. Bordi Disiplinor merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes. Bordi Disiplinor vendos për bashkimin e procedimeve, shtimin apo ndryshimin e objektit të procedimit disiplinor, sipas përcaktimeve të ligjit për noterinë.
2. Bordi Disiplinor merr vendim në lidhje me angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, shtyrjen e seancave, pranueshmërinë e provave, zgjidhjen e çështjes, si dhe çdo çështje tjetër që e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.
3. Marrja e vendimeve në mbledhjen e Bordit bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur.
4. Përrjashtimisht, votimet që kanë të bëjnë me etikën, cilësitë ose sjelljet e subjektit të procedimit disiplinor merren me votim të fshehtë.
5. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e ushtrimit të një vote. Në asnjë rast, e drejta e votës nuk mund t'i delegohet ndonjë anëtar tjetër të Bordit.
6. Vendimet e Bordit Disiplinor për çështje disiplinore miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të Bordit. Anëtari në pakicë mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Bordi.
7. Votat e anëtarëve të Bordit Disiplinor regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

TITULLI III PROCEDURA PËRPARA BORDIT DISIPLINOR

Neni 10

Njoftimi i subjektit ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor

1. Subjekti ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor njoftohet në lidhje me:
 - a) faktin se ndaj tij ka filluar procedim disiplinor dhe zhvillimin e seancës dëgjimore së paku 10 ditë përpara;
 - b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
 - c) të drejtën për të paraqitur me shkrim parashitjet mbrojtëse në afatin e caktuar;
 - ç) të drejtën për paraqitjen e dokumenteve brenda afatit të caktuar nga Bordi Disiplinor dhe thirrjen e dëshmitarëve që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
 - d) të drejtën për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative;
 - dh) të drejtën për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
2. Njoftimi i subjektit për të cilin është vendosur fillimi i procedimit disiplinor bëhet nëpërmjet postës elektronike zyrtare dhe në rrugë postare në adresat e deklaruara në regjistrat përkatës.
3. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Bordit Disiplinor, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 11

Vendimi përfundimtar

1. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, Bordi Disiplinor vendos:
 - a) për rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose
 - b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim nxjerrjen e urdhrit përkatës.
2. Bordi Disiplinor shqyrton masën disiplinore të propozuar nga ministri i Drejtësisë dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.
3. Vendimi përfundimtar përmban:
 - a) organin që ka marrë vendimin;
 - b) identitetin e subjektit ndaj të cilit është zhvilluar procedimi disiplinor;
 - c) datën e miratimit;
 - d) rrethanat e faktit dhe shkelja/shkeljet e pretenduara;
 - e) bazën ligjore;
 - f) pjesën arsyetuese;
 - g) dispozitivin që tregon;
 - h) të drejtën dhe afatet e ankimit;

- i) nënshkrimin e Kryetarit dhe sekretarit të Bordit Disiplinor.

Neni 12

Nxjerrja e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë, brenda 2 javëve nga data e paraqitjes së vendimit të Bordit Disiplinor dhe materialeve shoqëruese, nxjerr urdhrin për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor, në të cilin parashikohen edhe modalitetet e zbatimit të tij.
2. Urdhri për zbatimin e masës disiplinore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet noterit/zëvendësnoterit dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, me shkrim brenda 5 ditëve nga nxjerrja e tij.
3. Vendimi i formës së prerë për masën disiplinore evidentohet në regjistrin e noterëve a zëvendësnoterëve.

Neni 13

Ankimi

Kundër çdo vendimi të Bordit Disiplinor për shkelje disiplinore, Ministri i Drejtësisë, noteri ose zëvendësnoteri mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.